

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 51830/16

Marjan RROKU
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 51830/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 12 gusht 2016, nga shtetasi shqiptar z. Marjan Rroku, i lindur në vitin 1974 dhe i burgosur në Burrel (“kërkuesi”) i cili u përfaqësua nga z. A. Matoshi dhe Znj. R. Mundija, avokatë të licencuar në Tiranë dhe Shkodër;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”), të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin në lidhje me drejtësinë e procesit penal kundër tij dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë dhe gjykimin dhe dënimin e kërkuesit *in absentia* për vrasje në vitin 2002.
2. Kërkuesi, i cili në atë kohë punonte për Shërbimin Informativ Shtetëror të Shqipërisë u shpall i dyshuar për vrasjen e dy personave, më 29 mars 2001. Prokuroria filloi hetimin penal ndaj kërkuesit.
3. Meqë kërkuesi ishte i arratisur dhe pas kontroleve të pasuksesshme për kërkuesin në dy raste në banesën e tij dhe të prindërve të tij, ndaj kërkuesit filloi procesi penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u zhvillua një seancë në mungesë të tij. Fillimisht ai përfaqësohej nga një avokat i caktuar nga gjykata dhe më pas nga një avokat i zgjedhur nga familja e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e gjykoj kërkuesin *in absentia* për vrasje dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm. Ankimimet e njëpasnjëshme në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë të paraqitura nga avokati i zgjedhur nga familja e kërkuesit, u rrëzuan.
4. Në vitin 2014, kërkuesi u ekstradua në Shqipëri nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (këtu e më poshtë “SHBA”) dhe u vu në dijeni për dënimin ndaj tij. Në vitin 2015, kërkesa e kërkuesit për rishikim të vendimit të gjykatës (*rishikim i vendimit*) sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) për faktin që ai ishte gjykuar *in absentia* u rrëzua nga Gjykata e Lartë për arsye procedurale. Gjykata e Lartë vëren se rishikimi i një vendimi gjykate ishte masë e jashtëzakonshme që merrej sipas një liste shteruese të rrethanave, ku asnjë prej tyre nuk kishte të bënte me situatën e kërkuesit. Ajo u shpreh që i pandehuri duhej të kishte përdorur një mjet tjetër procedural, përkatësisht të kërkonte *rivendosje në afat* sipas nenit 147 të KPP-së, me qëllim rihapjen e procesit gjyqësor.

5. Më 30 mars 2016, Gjykata Kushtetuese nuk ra dakord me Gjykatën e Lartë për zgjedhjen e mjetit procedural të përdorur nga kërkuesi, duke vërejtur që nuk lindën pyetje në lidhje me pranueshmërinë e çështjes. Megjithatë, në themel, e rrëzoi ankimin kushtetues të kërkuesit në lidhje me gjykimin e tij *in absentia*, duke konstatuar që autoritetet kishin bërë gjithçka brenda kompetencave të tyre që kërkuesi të vihej në dijeni për procedimin penal kundër tij. Për të dalë në këtë konkluzion Gjykata Kushtetuese mori parasysh standardet përkatëse të praktikës gjyqësore të Gjykatës për këtë temë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

6. Parimet e përgjithshme përkatëse në lidhje me gjykimin *in absentia* përmbledhen në çështjen *Sejdovic kundër Italisë* [GC], nr. 56581/00, §§ 81–95, GJEDNJ 2006-II).

7. Palët nuk e kontestuan faktin që kërkuesi nuk ishte informuar për procedimin kundër tij.

8. Qeveria u shpreh që kërkuesi duhet ta ketë ditur për krimin që ai kishte kryer. Autoritetet kishin kontrolluar banesën e kërkuesit, por nuk e kishin gjetur sepse ai ishte fshehur dhe kishte jetuar në SHBA me një identitet të rremë për më shumë se dhjetë vjet. Në këto rrethana, kishte qenë objektivisht e pamundur që autoritetet të njoftonin kërkuesin për procedimin penal kundër tij.

9. Qeveria më tej u shpreh që kërkuesi qartazi i ishte shmangur drejtësisë dhe prandaj kishte hequr dorë nga të drejtat e tij sipas nenit 6, sepse ai kishte mjaft dijeni për krimin që kishte kryer dhe ishte fshehur. Qeveria dorëzoi një CD-ROM në mbështetje të parashtrimeve të saj e cila përmban një intervistë publike të kërkuesit nga qelia e tij në burg për një program televiziv në Shqipëri, ku ai pretendon se nuk i kujtohet se ka kryer krimin, sepse vuante nga amnezia, por ai pranon që ishte larguar nga vendngjarja dhe kishte siguruar një identitet të rremë për të imigruar në mënyrë të paligjshme në SHBA ku kishte jetuar për dhjetë vitet e tjera.

10. Kërkuesi parashtrroi që gjykimin *in absentia* kishte shkelur të drejtat e tij për t'u mbrojtur sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës. Ai pretendoi që nuk kishte dijeni për procesin penal kundër tij sepse autoritetet nuk e kishin njoftuar për këtë proces. Gjithashtu, ai pretendoi që ai nuk kishte hequr dorë qartazi nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë dhe për të mbrojtur veten, dhe as që kishte për synim t'i shmangej drejtësisë. Kërkuesi u shpreh që nuk i kujtohej ngjarja për shkak të amnezisë dhe pretendoi që fakti se kishte udhëtuar për në SHBA me një identitet të rremë nuk donte të thoshte që ai i ishte shmangur drejtësisë – shumë shqiptarë kishin bërë të njëjtën gjë gjatë atyre viteve.

11. Gjykata vëren se palët nuk e kontestojnë faktin që kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar *in absentia* dhe që ai nuk ishte njoftuar për procesin penal kundër tij. Gjithashtu është i pakonstestueshëm fakti që kërkuesi u fsheh menjëherë pas krimin për të cilin më pas ai u dënua *in absentia* dhe jetoi në SHBA me identitet të rremë për dhjetë vjet.

12. Në këto rrethana, Gjykata ka prirjen të pranojë argumentin e paraqitur nga Qeveria që kërkuesi kishte, ose duhej të kishte pasur, dijeni të mjaftueshme për ndjekjen penale të tij dhe për akuzat kundër tij, ose me fjalë të tjera, që ai e kishte ditur ose kishte dyshime se ai kërkohet nga autoritetet dhe ishte fshehur (krahasoni *çështja Medenica kundër Zvicrës*, nr. 20491/92, § 58, GJEDNJ 2001-VI, dhe bëni dallimin me *çështjen Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 69 et seq., 10 maj 2011). Gjithashtu, ndryshe nga çështja *Sejdovic* (cituar më sipër, paragrafët 99-101), ka faktorë objektivë që tregojnë se heqja dorë nga kërkuesi prej të drejtave të tij nuk është thjesht për shkak të statusit të tij si “i arratisur”, sepse ai mund të ketë parashikuar në mënyrë të arsyeshme pasojat e sjelljes së tij.

13. Nisur nga sa më sipër dhe nga i gjithë materiali përpara saj, Gjykata konsideron që kërkuesi, i cili është gjykuar *in absentia*, ka treguar se është përpjekur t'i largohet gjykimin ose të ketë hequr dorë

qartazi nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë. Prandaj, ankimi e kërkesit është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 paragrafi 3 të Konventës dhe duket të shpallet i papranueshëm.

Për këto arsye, Gjykata, unanimit,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 12 tetor 2023.

President: **Georgios A. Serghides**

Zëvendëskancelare: **Olga Chernishova**